

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F. dhe N.A. të dytë nga fshati ..., Komuna e Podujevës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson F.-C.M. avokate nga Prishtina, Rr. "NN", 30/D Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, C.nr.352/12, i datës 22.02.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.352/12, i datës 22.02.2013, në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit jo material për dhimbjet fizike, për frikën e përjetuar dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për paditësin F.A., ashtu që gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, që paditësit F.A., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, në emër të kompensimit për dhimbjet fizike ti paguaj shumën prej 3000 Euro, në emër të kompensimit për frikën t'ia paguaj shumën prej 2000 Euro dhe në emër të kompensimit për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor t'ia paguaj shumën prej 6000 Euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, për dhimbjet fizike, frikën dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, përtej shumave të gjykuara REFUZOHET SI E PABAZUAR.

II. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.352/12, i datës 22.02.2013, në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit material për shpenzime të mjekimit për paditësin F.A., ashtu që gjykohet: DETYROHET e Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit për shpenzime të mjekimit ti paguaj shumën prej 65 Euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuara REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.352/12, i datës 22.02.2013, në pjesën e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material për kompensimin e shpenzimeve për rehabilitim mjekësor për paditësin F.A., ashtu që gjykohet: REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve për rehabilitim ti paguaj shumën prej 800 Euro, SI E PABAZUAR.

IV. REFUZOHE e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë, në pjesën tjetër të kërkesëpadisë për paditësin F.A., lidhur me demin material për ushqim të përforcuar dhe shpenzime të procedurës ashtu që në këtë pjesë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.352/12, i datës 22.02.2013, VËRTETOHET.

V. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit në pjesën tjetër të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I (një) të dispozitivit pjesërisht e aprovon kërkesëpadinë e paditësve F.A., dhe N.A. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, si e bazuar. Nën pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “NN”, me seli në Prishtinë, t’ia paguaj paditësve për aksidentin e datë 08.10.2007, për pasojat e lëndimeve të pësuar dhe atë paditësit F.A. në emër të kompensimit të dëmit jo material shumë prej 22.500,00 €, dhe në emër të kompensimit të dëmit material në shumë prej 2.100,00 €, dhe paditësit N.A. për demin material në automjetin në shumë prej 1.953,00 €, e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë bankat afariste në Republikën e Kosovës kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 16.12.2009 dhe atë: paditësit F.A. në emër të dëmit jo material, në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 6.000,00 €, për frikë të përjetuar shumë prej 4.500,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 12.000,00 €. Në emër të dëmit material, për ushqim të sforcuar shumë prej 400,00 €, për rehabilitim mjekësor shumë prej 800,00 €, për shpenzimet të mjekimit shumë prej 900,00 €. Për paditësin N.A., në emër të dëmit material, për automjetin e tipit volksëagen/tip 19 EI, i dëmtuar, me targa 470-KS-347, shumë prej 1.953,00 €, ndërsa shuma përtej shumës së gjykuar në lartësisë prej 5.340,00 € për paditësin F.A. është refuzuar. Kërkesat për kujdesin e tjetrit, për paaftësi të përkohshme për punë dhe për gardërobë i ka refuzuar si të pabazuara. Nën pikën III (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “NN”, me seli në Prishtinë që paditësve t’ua kompensoj në emër të procedurës kontestimore shumë prej 1.967,00 €, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ankesën ta aprovoj si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj për demin jo material duke i gjykuar shumat sipas kriterëve ekzistuese, kurse për demin material që nuk ka prova të refuzohen, ndërsa për demin në veturë nuk është ankuar.

Ankesa e të paditurit i është dorëzuar paditëses por e njëjta nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit në gjykatën e shkallës së parë me datën 26/03/2008, kanë paraqitur padi kundër të paditurës për kompensim dëmi me propozim që kërkesëpadija të aprovohet sipas përmbajtjes së propozuar. Me anë të kërkesëpadiës është kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit ti kompensojë dëmin dhe atë për paditësin F.A.: dhimbje fizike në shumën prej 7000 Euro, për frikën e përjetuar shumën prej 5.500 Euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 12.000 Euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 400 Euro, për rehabilitim shumën prej 800 Euro, për shpenzime të mjekimit shumën prej 900 Euro, për paaftësi të përkohshme shumën prej 390 Euro, dhe për gardërobë të dëmtuar shumën prej 150 Euro, ndërsa për paditësin N.A. ka kërkuar kompensim për veturën në shumën prej 1.953 Euro.

Gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor, pas administrimit të provave të propozuar nga palët ndërgjyqësore ka vendosur në mënyre meritore për kërkesëpadijën duke e aprovuar të njëjtën pjesërisht me përmbajtje si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se në seancën e datën 22/02/2013, ka administruar provat për vërtetimin e fakteve vendimtare lidhur me themelësinë e kërkesëpadiës, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së ka gjetur se kërkesëpadija është pjesërisht e bazuar. Lidhur me gjendjen faktike ka arsyetuar se në bazë të raportit të shërbimit policor të Kosovës me nr. 07-AR-01721, të datës 08/10/2007, ka vërtetuar se aksidenti ka ndodhur me datën 08/10/2007 dhe në të njëjtin kanë qenë të përfshira tri vetura.

Lidhur me bazën respektivisht përgjegjësinë e të paditurës për t'iu kompensuar dëmin paditësve, Gjykata ka arsyetuar se e ka vërtetuar në bazë të aktgjykimin të Gjykatës Komonale në Prishtinë P.nr 103/08, me klauzolë të formës së prerë nga data 29/03/2012, nga është vërtetuar se drejtuesi i automjetit Kamionet e lehtë – Mercedes 508, me targa 510 KS 340, J.I. është shpallur fajtor. Edhe me ekspertizën e komunikacionit të datës 02/12/2008, e përpiluar nga Xh.P. – ekspert i komunikacionit, është konstatuar se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur për arsye se janë bërë lëshime nga ana e drejtuesit të automjetit Kamionet e lehtë – Mercedes 508, me targa 510 KS 340, të cilën në momentin e shkakimit të aksidentit e drejtonte J.I.

Lidhur me natyrën e lëndimeve që e ka pësuar paditësi F.A., Gjykata ka arsyetuar se në cilësinë e provës materiale ka nxjerrur ekspertizën mjekësore të punuar nga ekspertët Xh.S. – Ortoped Traumatolog dhe N.M. – Psikiatre. Në bazë të ekspertizës mjekësore është konstatuar se paditësi ka pësuar ndrydhje të kokës dhe trupit, krahërorit, belit dhe regjionit vehtor, e shoqëruar me thyerje të unazës së tretë.

Lidhur me frikën e përjetuar nga paditësi Gjykata ka konstatuar se në bazë të mendimit të ekspertes së neuropsikiatres rezulton se paditësi ka përjetuar frikë primare në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi direkt për integritet të tij fizik, e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare e intensitetit të lartë me kohëzgjatje tri ditë, e shoqëruar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit, shqetësim psikomotorik dhe zgjime të shpeshta gjatë natës. Frika pastaj ka kaluar në frikë sekondare të një intensiteti më të ulët me kohëzgjatje prej 12 muaj, e cila fillimisht është shoqëruar me frikë nga invaliditeti i përhershëm, nervoz, humbje durimi dhe pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Gjykata duke marrë për bazë mendimin dhe konstatimin e eksperteve N.M. dhe Xh.S. sipas të cilit ka rezultuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike sipas aksidentit, zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë 20%, ushqim i përforcuar që ka qenë i nevojshëm 90 ditë, rehabilitimi fizioterapeutik-klimatik ka qenë i nevojshëm për 3 herë nga 10 ditë pas muajit të nëntë nga lëndimi dhe brenda 24 muajve, duke u bazuar në nenin 200 të LMD-së ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Për të vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit përveç të cekurave gjykata ka arsyetuar se ka marrë në konsideratë rrethana që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë: intensiteti i dhimbjeve, kohëzgjatja e tyre, intensiteti i frikës dhe zvogëlimi i aktivitetit jetësor, duke vlerësuar se shumat e caktuara do të ofrojnë satisfacionin e duhur për dhimbjet e përjetuara dhe do të ndikojnë në dhënien e baraspeshës psikike dhe emocionale. Për pjesën e refuzuar gjykata ka theksuar se ka vendosur në formë të tillë në mungesë të provave.

Lidhur me dëmin material për paditësin N.A. gjykata mori për bazë ekspertizën teknike lidhur me vlerësimin e dëmit në automjetin motorik, e ponuar nga eksperti Nexhmi Shala, sipas të cilës ka rezultuar se dëmi i shkaktuar në automjet është 1.903 Euro, ndërsa për shumën prej 50 Euro gjykata ka arsyetuar se ka marrë për bazë faturën e datës 14.11.2007, e cila i referohet pagesës për shërbimin e transportit të veturës së dëmtuar.

Gjykata ka arsyetuar edhe refuzimin e propozimit për marrjen e super ekspertizës së komunikacionit për arsye se në shkresat e lëndës ekziston aktgjykimi penal lidhur me përgjegjësinë e aksidentit, rrjedhimisht edhe ekspertiza e komunikacionit nga ka rezultuar se shkaktar i aksidentit është i siguruari tek e paditura.

Për shpenzimet e procedurës gjykata i është referuar nenit 452 paragrafi 2 të LPK-së, ndërsa për lartësinë i është referuar tarifës së odës së avokatëve dhe dëshmi pagesave për taksa gjyqësore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, nga se, sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për

faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë. Aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsytimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallë së parë ka vendosur brenda kërkesave të palëve dhe pretendimi i të paditurës për tejkalim të kërkesëpadisë nuk është i themeltë.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket dëmit jo material për dhimbjet fizike, frikën dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjendje për kategoritë e dëmit për të cilat është vendosur në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit është konstatuara në mënyrë të drejtë dhe të plotë sepse gjykata me ekspertizë mjekësore të punuar nga ekspertet e ortopedisë dhe neuropsikiatrisë ka vërtetuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore. Si pasojë e lëndimit trupor ka përjetuar dhimbje fizike në kohëzgjatje me intensitet posaqërisht të rëndë një orë, me intensitet të rëndë pesë ditë, me intensitet të mesëm 28 ditë dhe me intensitet të ulët edhe në kohën kur është punuar ekspertiza. Kohëzgjatja dhe llojet e frikës janë përshkruar me lartë, ndërsa kufizimi i aktivitetit i përgjithshëm jetësor të paditësi shprehet në shkallë 20 %.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategoritë e dëmit jo material pasi që vlerësoj se shumat e gjuakuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimit. Në çdo rast për dëmin jo material gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimit ti shkojë përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material, e që është satisfakcioni për të dëmtuarin.

Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh natyrën e rëndë të lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuara frika, *(me frikë nga invaliditeti i përhershme, etj.,)*

zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe mënyrën se si manifestohet ky zvogëlim/kufizim si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktikën e mirë gjyqësore për këto lloje të dëmit ka vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit Gjykata e Apelit vlerëson se shumica e gjykuar nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që nga provat në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi ka arritur ti provoj shpenzimet e mjekimit vetëm në lartësi prej 65 Euro, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesës lidhur me këtë kategori të dëmit nuk ka prezantuar dëshmi. Për bazë ligjore për pranimin e shpenzimeve lidhur me shërimin Gjykata e Apelit i referohet dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 të LMD-së.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën III (tre) të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse nga provat e shkresës së lëndës nuk provohet se paditësi ka shpenzuar shumën e kërkuar për tretmant fizikal – klimaterik. Në këtë rast Gjykata e Apelit nuk ka mundur ta pranohet si të rregullt përfundimin e shkallës së parë se vlerësimi me ekspertizë mjekësore për nevojën e tretmanit fizikal përfaqëson bazë edhe për lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit. Duke qenë se kërkesa për shpenzime lidhur me tretmanin fizikal është kategori e dëmit material rezulton se paditësi do të duhej që të paraqiste prova, përveç për bazën edhe për lartësinë.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën IV (katër) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e pranuar si të rregullt përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me lartësinë e kërkesës për ushqim të përforcuar dhe për shpenzime të procedurës, për shkak se nga ekspertiza mjekësore rezulton se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej dyzet ditësh, ndërsa lartësia e aprovuar për ushqim të përforcuar është brenda limiteve të praktikës gjyqësore për këtë kategori të dëmit. Është pranuar si i rregullt përfundimi për lartësinë edhe pse nuk ka ndonjë dëshmi me të cilit do të provohet lartësia e kërkesës, por zakonisht ushqimi i përforcuar merret brenda familjes dhe rëndom vlera e ushqimit të përforcuar nuk provohet me provë materiale. Edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në harmoni me dispozitat e referuara të LPK-së, e rrjedhimisht edhe me natyrën e veprimeve për të cilat pranohen shpenzimet në këtë rast për përfaqësinë dhe taksat gjyqësore të cilat po ashtu janë në harmoni me tarifën e odës së avokatëve dhe me dëshmi- urdhëresat e taksës gjyqësore.

Është vendosur si në pikën V (pesë) në dispozitivin e këtij aktgjykimi sepse me ankesë nuk ka qenë i kontestuar i tërë i dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjatë procedurës ka qenë pretendim i të paditurës baza juridike e kërkesëpadisë e cila nuk e ka paraqitur si pretendim me ankesë, madje është propozuar ndryshimi i vendimit pa u kontestuar baza juridike e kërkesëpadisë, por si do që të jetë Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në provat e administruar siç janë aktgjykimi penal dhe ekspertiza e komunikacionit e ka konstatuar dhe provuar në mënyrë të mjaftueshme përgjegjësinë e të paditurës për të kompensuar dëmin sipas përgjegjësisë objektive.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika, d) dhe e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1760/13, me datë 10.10.2017

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v